



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:145144
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06201442

A.C.nr.5742/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Frosina Sylejmani, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve Sh.M dhe H.M, që të dy me vendbanim në rr. "...", nr.20, Komuna Pejë, të cilët i përfaqëson me autorizim H.N, avokat me seli në Komuna Pejë, kundër të paditurit R.M me vendbanim në rr. "R...", nr.125, Komuna Pejë, në çështjen për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.765/19 datë 07.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET ankesa e paditësve Sh.M dhe H.M, që të dy me vendbanim në rr. "...", nr.20, Komuna Pejë, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.765/19 datë 07.07.2023, e **PA LEJUESHME**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.765/19 datë 07.07.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

"... I. NDERPREHET PROCEDURA në këtë çështje kontestuese me C.nr.765/19 të paditësve, Sh.M, dhe H.M, të dy nga Peja, Rr. ..., nr. 20, Pejë, e kundër të paditurit, R.M, nga Peja, Rr. R..., nr. 125, Pejë, me bazën juridike, për vërtetim pronësie në paluajtshmeri, vlera e kontestit 5,000 euro.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë pas pushimit të shkaqeve për të cilat është ndërprerë, apo kur të njëjtit i thërret Gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palëve ndërgjyqësore..."

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, me propozim që të miratohet propozimi i paditësit në tërësi.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe parashtresën e paditësit për tërheqje të ankesës e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 209 pika a), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

- Hedhet ankesa si e palejueshme.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pasi që ka administruar provat ka vendosur që të ndërprehet procedura kontestuese e paditësve, duke vendosur më shumë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Paditësit me datë 20.07.2023, kanë parashtruar ankesë, duke e kundërshtuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.765/19 datë 07.07.2023.

Paditësit me datë 21.05.2024, në Gjykatën Themelore në Pejë, kanë parashtruar parashtresë më të cilën e tërheqin ankesën e parashtruar kundër aktvendimit, me të cilin ndërprehet procedura në këtë çështje kontestuese me C.nr.765/19, të paditësve, Sh.M, dhe H.M, që të dy nga Peja, Rr. ..., nr. 20, Pejë, kundër të paditurit, R.M, nga Peja, Rr. ..., nr. 125, Pejë, me bazën juridike, për vërtetim pronësie në paluajtshmeri, vlera e kontestit 5,000 euro.

Andaj bazuar në faktin se paditësit e kanë tërhequr ankesën, Gjykata e Apelit e ka hedhur ankesën si të palejueshme, duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 1 e lidhur me paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *“ankesa është e palejueshme po që se e ka parashtruar personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”*.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 209 pika (a) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.5742/2023 datë 23.09.2024

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi**